

Op-Ed nga Ambasadorja Angelika Viets lidhur me zhvillimet politike dhe ekonomike në Kosovë dhe vizioni i saj për vitin 2017. Publikuar në numrin festiv (30.12.2016) të gazetës ditore kosovare Kosova Sot.

Jemi të lumtur për Kosovën dhe qytetarët e saj që në vitin që po e lëmë pas në disa fusha është shënuar progres. MSA-ja ka hyrë në fuqi, edhe pse ngadalë, është zbatuar dhe efektet e para pozitive janë të dukshme: po vijnë më shumë investitorë, ndër të tjera nga Gjermania, po krijohen vende pune dhe në përputhje me këtë, kuotat e papunësisë kanë rënë. Kjo vetëm pak ka të bëjë me faktin se që nga fillimi i vitit më shumë se 5000 kosovarë kanë përfituar nga mundësia e punësimit në Gjermani. Varfëria, sipas Bankës Botërore është reduktuar. Kemi takuar shumë njerëz të angazhuar në këtë vend, të cilët me forcë vepruese, me ide dhe gatishmëri për të rrezikuar dëshirojnë të çojnë përpara vendin e tyre. Ashtu siç kjo na bën neve optimistë, këto suksese do të duhej të ishin arsye për mediet për të raportuar për një kthesë të re të mundshme të shoqërisë, duke mos kritikuar në vazhdimësi gjithçka dhe çdo gjë, duke mos de-inkurajuar lexuesit dhe përkeqësuar imazhin e Kosovës në kryeqytetet tona, i cili atje edhe ashtu nuk është veçanërisht i mirë.

Ne kemi vuajtur bashkë me Kosovën dhe me qytetarët e saj për faktin që as këtë vit nuk u hoq regjimi i vizave – liberalizimin do të jua kishim dëshiruar juve, por edhe personelit tonë, i cili në vitin 2016 i ka shqyrtuar rreth 40.000 kërkesa për viza. Topi, siç dihet është në anën e Kosovës, deri sa të plotësohen dy kriteret e fundit nga udhërrëfyesi i vizave. Në pranëverë të këtij viti, ne së bashku me një kartograf gjerman kemi kontribuar në grupin ndërkombëtar të ekspertëve, i cili e ka rishqyrtuar Marrëveshjen e Demarkacionit me Malin e Zi dhe e ka konfirmuar shënimin korrekt të kufirit. Me këtë diskutimi për këtë temë ka mundur të jetë përmbyllur.

Mirëpo shumë të brengosur jemi me „politikën“, e cila e ka pushtuar tablon e shtypit dhe të dëshpëruar jemi me shumë prej disave, të cilët janë përgjegjës për bllokadat e gjata. Krahas një vullneti të paktë të mirë, aty shohim shumë jokompetencë, mungesë të dijes rreth aspekteve të ndërlikura dhe detyrimeve, shumë egoizëm, shumë dogmatizëm e kryeneqësi, indiferencë dhe komoditet, por herë herë edhe qëllime jo të mira dhe destruktive. Në këtë mënyrë për fat të keq është sillur në vend Kosova politike edhe këtë vit.

Cilat çështje do të duhej t'i përcaktonin veprimet e politikanëve? Këtu shikimi do të duhej pikë së pari të kthehej nga brenda: A janë mirë qytetarët tanë? A janë ata më mirë se sa më parë në Kosovën tonë të pavarur, për të cilën kanë rënë shumë viktima? A kanë të gjithë një mundësi për punësim? A mund t'ia dalin me pagat që i marrin? A iu sigurojmë ne sigurime dhe shërbime shëndetësore? A iu ofrojmë fëmijëve një arsim cilësor? A iu japim pakicave tona, në veçanëti serbëve të Kosovës arsye të mira për t'u integruar në jetën tonë? Përgjigja në këto pyetje në fund të vitit 2016, të cilën na e kanë dhënë njerëz të panumërt këtë vit, për fat të keq është një „Jo“ e qartë.

Kur ne i përmendim këto në takime me bartës së funksioneve në parlament, në qeveri apo në parti, shpeshherë na thuhet: ka vetëm 17 vjet që kemi dalur nga lufta. Ose: ka vetëm 8 vjet që jemi pavaruar. Ose: janë rrethanat e vështira. Vendet që nuk na kanë njohur. Raportet e vështira me

Serbinë. E saktë, të gjitha këto janë të vërteta. Mirëpo e vërtetë është poashtu se Kosova është një shtet i vogël me vetëm 1,7 milion banorë. Bashkësia ndërkombëtare është angazhuar këtu më shumë se pothuajse në të gjitha vendet e tjera. Këtu ka një ushtri këshilltarësh. Ka një mbështetje të madhe financiare. Diaspora kontribuon me 30% në buxhetin shtetëror të Kosovës. Për këto arsye, me të vërtetë, sikur të ishin shfrytëzuar më mirë këto resurse, është dashur të ketë përparim më të shpejtë.

Apo nuk përputhen prioritetet politike? A nuk është mirëqenia e përgjithshme gjithëmonë para interesave personale? A mos e kanë humbur politikanët konsensusin kombëtar me rastin e shpalljes së pavarësisë për t'u angazhuar së bashku për një Kosovë të suksesshme?

Një gjë është e sigurtë: Kosovës po i ikën koha dhe miqtë të Kosovës po e humbin durimin. "Bota ka shakalluar", ka konstatuar në mënyrë të përsëritur ministri ynë i jashtëm në largim, Steinmeier, duke pasur parasysh të gjitha krizat katastrofale dhe gjithnjë e më të shpeshta në botë, ndërsa ne akoma merremi me çështjen: a do t'ia dalë Kosova?

Vizioni im për 2017 është ky: unë shoh politikanë, të cilët sërish janë më shumë në vendin e tyre, se sa jashtë tij, sepse dëshirojnë t'i shërbejnë me prioritet dhe t'i vënë gjërat në rregull. Ata flasin me njëri-tjetrin dhe i respektojnë afatet kohore, zotimet dhe detyrimet. Në këtë mënyrë planet legjislative miratohen me kohë, investitorët nuk largohen sërish dhe shkollat nuk kërcënohen të mbyllen. Në përgjithsi komunikohet shumë, politika iu sqarohet qytetarëve, parlamenti informohet, ministrat japin përgjegjësi, deputetët praqiten në seancat parlamentare dhe arritja e kuorumit nuk vihet në pikëpyetje. Ata dëgjojnë, përmbahen nga argumentimet kundërthënëse dhe distancohen nga bojkoti, sepse këto e pengojnë pjesëmarrjen aktive. Donatorët në mënyrë të vetëkuptueshme mund të llogarisin që mjetet e tyre janë të mirëseardhura dhe pranuesit e atyre mjeteve me dëshirë i krijojnë parakushtet e nevojshme për t'i pranuar. Mirëkuptimi për rëndësinë e dialogut me vendin fqinj dhe për zbatimin e dy-anshëm të marrëveshjeve rritet, sepse lehtësirat për qytetarët janë të dukshme tej e tej.

Jo partia, por njeriu gjendet sërish në plan të parë. Secili qytetar ka një mundësi të drejtë për pjesëmarrje. Notat në shkollë, vendet e studimit, vendet e punës dhe pozitat jepen mbi bazën e performancës dhe aftësive dhe askujt nuk i shkon ndër mend për të vënë këtë në pikëpyetje nëpërmjet presionit, ushtrimit të ndikimit dhe kërcënimit, duke e dëmtuar në këtë mënyrë shtetin e vet. Prindërit e mbështesin këtë kurs, sepse duan që diplomat e fëmijëve të tyre të kenë vlerë. Njerëzit që paguhen për punën e tyre, punojnë. Ata avancojnë arsimimin e tyre dhe marrin mbështetje për këtë nga punëdhënësit në administratë dhe në shkolla. Ata angazhohen dhe kontribuojnë në zhvillimin e vendit të tyre. Të gjithë këtë e bëjnë, jo për hir tonin, por për hir të Kosovës!

Të dashur kosovarë në qeveri, në opozitë, në shoqërinë civile: E ardhmja varet nga ajo që bëjmë ne sot! (Ghandi) Ju lutem diljani mbanë!

Shkruar më 17.12.16